



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 278/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI) dega në Ferizaj, për shkak të zhvillimit të fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj .

Arsyetim

Me datën 18.10.2013, PDAK-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 16.10.2013, në lagjen Aibish, në fshatin Dubravë, në shtëpia private militantët e PAI-së kanë organizuar takime, duke mos e lajmëruar KKZ-në dhe policinë, ku edhe e ka ofenduar PDAK-në shumë rëndë. Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PAI me datën 16.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.2013 deri në ora 14:00.

PZAP-i, e pranoi përgjigjen e kërkuar nga PAI-ja, sipas afatit të caktuar, dhe ka shtuar se në përgjigje të ankesës me datë 23.10.2013 PAI-ja, ka theksuar se, ankesa e parashtruar nga PDAK-ja është krejtësisht e pa bazë dhe e montuar për ta dëmtuar këtë parti politike . Pranadaj me tutje ka theksuar se, PAI-ja nuk ka mbajtur asnjë takim elektorale pa i njoftuar organet gjegjëse, ndërsa tubimet e vetme të cilat janë mbajtur janë ato të mbajtura në lagjën Sallhane në shtëpinë e z. Imri Qukolli më datë 17.10.2013 për të cilin takim është njoftuar KKZ-ja dhe policia e Kosovës, dhe kemi qenë në vëzhgimin e organizatës Demokracia në Veprim . Në fshatin Dubravë, fushata është mbajtur me datën 20.10.2013 dhe e njëjta është lajmëruar nga organet gjegjëse .

Sa i përket fotove, kinse si dëshmi për fushatë të pa paralajmëruar në shtëpinë e Nexhmedin Rexhepit, PAI-ja në munges të zyreve të saja, ka mbajtur takimin e saj me kryesin e nëndegës Koce Xoxe dhe Halit Ibish, fotoja e pasyquruar në këtë ankesë, është foto e takimeve tona si kryesi e jo e fushatës zgjedhore dhe dëshmia tjetër është fotografi e takimit të kryesisë dhe të kandidatëve pikërisht në zyret e PAI-se ne Ferizaj dhe nuk kanë qenë tubime elektorale .

PZAP-i, pasi që administroi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga PDAK-ja, pretendohet se militantët e subjektit politik PAI, në lagjën Aibish, në fshatin Dubravë, në shtëpitë private kanë organizuar fushatë pa paralajmërimin e KKZ -së dhe policisë së Kosovës, ku edhe e kanë ofenduar rëndë PDAK-në.

PZAP-i, gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë, ngase dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk është objektive, me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nga fotografitë e ofruara si prova nga PDAK-ja, shihet se është organizuar mbajtja e takimeve nga radhët e PAI-së, mirëpo një veprim i tillë nuk është i ndaluar sipas dispozitave të LZP-së.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante nga fotografitë e paraqitura si dëshmi bindëse, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, neni 3.6 pika b), dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 278/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridik: PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*